

VENDIM
Nr. 867, datë 30.12.2024

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITET
PUBLIK PRIVAT, PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN,
MIRËMBAJTJEN, REHABILITIMIN DHE TRANSFERIMIN E SEGMENTIT
RRUGOR LEKAJ-KONJAT-FIER, NDËRMJET MINISTRISË SË
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE BASHKIMIT TË OPERATORËVE
EKONOMIKË “FUSHA” SHPK, “AGBES KONSTRUKSION” SHPK, “ALBAVIA”,
SHPK, “KUPA” SHPK, “ANTE-GROUP” SHPK, “KLODIODA” SHPK, “A.L.T.E.A. &
GEOSTUDIO 2000” SHPK DHE “SPHAERA” SHPK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26, pika 9, e 41, pika 2, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit/partneritet publik privat, për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen, rehabilitimin dhe transferimin e segmentit rrugor Lekaj–Konjat–Fier, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Fusha” sh.p.k., “Agbes Konstruktion” sh.p.k., “Albavia” sh.p.k., “Kupa” sh.p.k., “Ante-Group” sh.p.k., “Klodioda” sh.p.k., “A.L.T.E.A. & Geostudio 2000” sh.p.k. dhe “Sphaera” sh.p.k., që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku